

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvend dhe protestë, parlamenti i Shqipërisë dënon vendimin e Hagës: Liderët e UÇK luftuan për liri
ADRESA	https://versus.al/live-updates/kuvend-dhe-proteste-parlamenti-i-shqiperise-demon-vendimi-n-e-hages--i46698
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:29:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 10:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b943c2e6487e512e2bcbdd39a43e99c7158c6a770e509e448b78035376d6e251
TEKSTI	60cdb90d38fd30bc8484f1e4fe9e2cca683cb51e509aa7d4cdcd7dd2ddfeaa8e
PAMJA	52267b1c34c129becdfabf8bb89a257662d39294ef73c09a2e5d9ebe6be3bea2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c6264107622735c5589bb665131bd0f72e5ad425803b9fc34f447cfa997c146
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c6264107622735c5589bb665131bd0f72e5ad425803b9fc34f447cfa997c146>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

Kuvend dhe protestë, parlamenti i Shqipërisë dënon vendimin e Hagës: Liderët e UÇK luftuan për liri

17 Shtator 2026, 12:10

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 17 Shtator 2026, 12:10

Kuvend dhe protestë, parlamenti i Shqipërisë dënon vendimin e Hagës: Liderët e UÇK luftuan për liri

*Sot në seancën plenare të Kuvendit pati debate për dënimin e dhënë dje nga gjykata e Hagës për liderët e UÇK. Ndërsa opozita akuzoi qeverinë se nuk kishte votuar për miratimin e rezolutës që dënon genocidin serb në Kosovë, socialistët kërkuar që Kuvendi të dalë me një deklaratë të përbashkët zyrtare. *Ndërkohë jashtë Kuvendit, policia kishte bllokuar të gjitha rrugët për të mbrojtur deputetët teksa hynin në seancë plenare. Protestuesit të cilët kërkonin dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama dhe të klasës së vjetër politike, u përplasën me policinë, ndërsa pati persona të shoqëruar në policinë. *Kuvendi i Shqipërisë doli me një deklaratë të përbashkët kundër aktgjykitimit të djeshëm në Hagë ndaj liderëve të UÇK.



Shkruar nga Versus

Çfarë do të gjeni në brendësi

*Sot në seancën plenare të Kuvendit pati debate për dënimin e dhënë dje nga gjykata e Hagës për liderët e UÇK. Ndërsa opozita akuzoi qeverinë se nuk kishte votuar për miratimin e rezolutës që dënon genocidin serb në Kosovë, socialistët kërkuar që Kuvendi të dalë me një deklaratë të përbashkët zyrtare. *Ndërkohë jashtë Kuvendit, policia kishte bllokuar të gjitha rrugët për të mbrojtur deputetët teksa hynin në seancë plenare. Protestuesit të cilët kërkonin dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama dhe të klasës së vjetër politike, u përplasën me policinë, ndërsa pati persona të shoqëruar në policinë. *Kuvendi i Shqipërisë doli me një deklaratë të përbashkët kundër aktgjykitimit të djeshëm në Hagë ndaj liderëve të UÇK.

6 Postime

7 MINUTA ME PARE

“Shprehim indinjatën e thellë”, Kuvendi i Shqipërisë dënon vendimin e Hagës për liderët e UÇK



Me një deklaratë të përbashkët që shpreh qëndrimin e gjithë deputetëve, Kuvendi i Shqipërisë dënoi vendimin e dhënë dje nga Gjykata e Hagës ku 4 liderët e UÇK u dënuan me 81 vite burg në total.


Kryeparlamentari Niko Peleshi lexoi deklaratën që u duartrokoi nga gjithë deputetët duke theksuar se lufta e UÇK kishte qenë për lirinë e Kosovës dhe se nuk duhej që komuniteti ndërkombëtar të barazonte viktimën me agresorin.

“Kuvendi i Shqipërisë shpreh kundërshtinë dhe indinjatën e thellë ndaj një vendimi që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Selimit, Krasniqit dhe Veselit. Lufta e UÇK ishte për lirinë, ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes. Ai lindi si përgjigje ndaj spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga Slllobodan Millosheviçit. UÇK ishte forcë vendimtare e popullit të Kosovës. Thaçi, Veseli, Selimi e Krasniqi janë të pandashëm nga ky qëllim. Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli apo të barazojë agresorin me viktimën. Shpresim shqetësimin e thellë për standartet e dyfishta në gjykimin e së kaluarës së përgjakshme”- thuhet mes të tjerash në deklaratën e Kuvendit. **Versus.al**

2 ORE ME PARE

Berisha për dënimin e liderëve të UÇK: Rama dhe Vuçiç janë përgjegjës direkt





Kryedemokrati Sali Berisha gjatë fjalës së tij në foltoren e Kuvendit foli për dënimin e djeshëm ndaj liderëve të UÇK-së.

Berisha akuzoi kryeministrin Edi Rama duke e rreshtuar si përgjegjës direkt së bashku me presidentin serb, Aleksandër Vuçiç.

"Së fundi, ai Padrinoja juaj, pas kësaj që ndodhi në Hagë, në qoftë se ka njeri më përgjegjës direkt për atë që ndodhi, është Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama.

Ku e keni tani, e keni parë të çelë ndonjë gojë, më thoni pak çfarë tha ai? Thuaj çfarë fjalë ka shqiptuar? Apo ai ministri i tij? Se u zhdukën këta. Këta sjellin këtë, që ky ka imunitet të vjedhë ditë e natë dhe thotë faleminderit, më lini të vjedh më shumë. Ky që kam këtu.

Se ky mobilizon të gjithë familjen, u jep kompani. Niko, ja ku e ke zëvendësin, aty e ke. Niko, të thashë se e ke zëvendësin gati. Po, po, do e heqin edhe atë"- tha Berisha mes të tjerash. **Versus.al**



3 ORE ME PARE

Përplasje me policinë jashtë Kuvendit, protestuesit tentojnë të heqin kordonin metalik



Sot në ditën e 110-të të protestës për rrëzimin e qeverisë dhe të klasës së vjetër politike, qindra qytetarë u mblodhën para Kuvendit teksa mbahet seanca plenare.

me unitet ne mbeshtetje te UÇK-se une ato per doreneqjen e kames une te klases se vjeter ponuke, qytetaret u perishtine edhe ne perpiasje me policine.

Ata tentuan të hiqnin kordonin metalik me të cilin ishte rrethuar perimetri i sigurisë. Ndërsa pas tensioneve, njëri prej protestuesve u shoqërua për në polici. **Versus.al**



3 ORE ME PARE

Dënimi i krerëve të UÇK, Balla: Na dhemb shpirti, por Kuvendi do bëjë deklaratë! Kapri: Lot krokodili, duhet rezolutë




Taulant Balla, Erald Kapri

Dënimi i liderëve të UÇK-së ditën e djeshme në Hagë ishte temë debati në seancën e sotme plenare ku deputetët opozitarë kërkuar futjen me procedurë të përshpejtuar të rezolutës së njohjes së genocidit serb në Kosovë.

Ndërsa kreu i grupit parlamentar Taulant Balla tha se Kuvendi do të mbante një deklaratë të dakordësuar nga të gjithë deputetët për gjyqin e djeshëm ku u dënuan Thaçi e të tjerët. Më tej kritikoi kërkesën e Kaprit për të pritur derisa të ishte i pranishëm edhe Shehaj për deklaratën e Kuvendit.

"Shkuam në pikën që ne nuk duhet të shprehemi për clirimitarët se na mungon Agron Shehaj. Të lutem shumë kryetar besoj se po afron momenti që duhet të kemi atë deklaratën gati që diskutuam. Unë kam heshtur sot, besoj se të gjithëve na plas shpirti këtu për t'i thënë ca fjalë për atë vendim dje, por e kemi dakordësuar se do flisni ju në emrin tonë, për të qenë seriozë. Na dalin dhe na thonë mos votoni deklaratën për Kosovën se na mungon Agron Shehaj edhe të të plasi 2 herë shpirti, jo njëherë"- tha Balla.





Ndërsa nuk mungoi përgjigjia e Kaprit i cili tha se duhet rezolutë dhe veprime konkrete për t'u ardhur në ndihmë krerëve të UÇK. Ai kritikoi Ballën për gjuhën e përdorur dhe tha se duhej të mbanin përgjegjësi për dështimin në mbrojtjen e luftës së Kosovës.

“Dje lëshonte lot krokodili për vendimin e Hagës. Dalin këtu për një kërkesë minimale që të mos mungojë njeri në deklaratën unifikuese dhe flasin me gjuhë dhune. Nëse ky parlament do të duhet të bënte diçka duhet rezolutë, jo thjesht deklaratë. Duhet para buxhet, të përcaktohet sesa do harxhojmë për të mbrojtur çështjen e kombit shqiptar. Sepse jemi në situatë dëshpëruese dhe askush nuk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.